



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 26 tetor 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Vladimir Todorović, Kolë Berisha dhe Muferra Şinik.

Mungoi: Adem Salihaj.

Të pranishëm: Georgi Rupchev – EU – AC Project, Afrim Atashi – AKK, Lendita Kastrati – Eu-AC, Xhevat Balaj OAK, Reshit Gashi - NDI, Petrit Hysaj – OSBE, Besnik Boletini – Bota Sot, Rrezarta Ahmeti – KDI, Malva Govori - ECLO dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 tetorit 2009,
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ish-in plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 tetorit 2009

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryetari – I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe mbikëqyrësit e punës së Komisionit. Tha se do ta vazhdojmë shqyrtimin e propozimamendamenteve prej neni 10 pika 9, aty ku kemi mbetur dhe të vendosim a duhet të publikohet në mjetet e informimit deklarimi i pasurisë. Jemi për transparencë, por duhet të kihet kujdes të mos e shkelim privatësinë që është e garantuar me Kushtetutë. Organizatat që e mbështesin punën e Komisionit janë për publikimin e pasurisë. Edhe administrata ka konsultuar ekspertë të ndryshëm, sepse ka dilema rreth kësaj çështjeje, prandaj hap debat që ta shfaqni mendimin tuaj.

Ibrahim Makolli - Tha se jemi të interesuar për transparencë, por nuk e di se ekziston diku një praktikë që pasuria e dikujt të bëhet publike. Pasuria mund të bëhet publike nëse autoriteti i interesuar e kërkon këtë. Në vazhdim pyeti se a ka mekanizëm që e mbron nga veprimet kriminale personin që e deklaroi pasurinë. Pajtohem të mbetet si në Projektligj, sepse nëse dikush dëshiron ta dijë pasurinë e dikujt, duhet të bëjë kërkesë dhe të identifikohet me gjithë bazën e të dhënave, që të dihet se kush ka qenë i interesuar të këtë informacione të tilla.

Adem Hajdaraj - U pajtua me parafolësin se qasja në informacione rreth pasurisë duhet të bëhet vetëm me kërkesën e palës së interesuar. Njëkohësisht u pajtua se duhet të mbetet si në Projektligj, sepse kjo bie ndesh me Ligjin për qasjen në të dhënat personale.

Georgi Rupchev - Në fjalën e tij tha se shumë çështje, që janë diskutuar në mbledhjen e kaluar, ishin kundër transparencës. Sa për sqarim tha se nenet e Kushtetutës për privatësinë, për të drejtat themelore të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën për të jetuar, nuk janë vetëm në Kushtetutën e Kosovës, por edhe në kushtetutat e vendeve të tjera, prandaj këto çështje, në këtë rast nuk mund të parashtrihen si valide. Mori shembull deklarimin e pasurisë nga zyrtarët e lartë që bëhet në Shqipëri dhe në Maqedoni. Përderisa traditat e shqiptarëve janë si në Kosovë, pse në Shqipëri dhe në Maqedoni mund të bëhen publike, kurse në Kosovë jo? Konsideroj se më mirë do të ishte të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë të gjitha deklaratimet e pasurisë. Ky ka qenë edhe propozim i dalë nga Agjencia, të cilin e kemi përkrahur edhe ne, edhe shoqëria civile.

Selvije Halimi - Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se as ajo, as ndonjëri nga ne nuk kemi qenë kundër transparencës së pasurisë së zyrtarëve të lartë. Shtoi se jemi për atë që ta gjejmë një model, i cili nuk do ta dëmtonte privatësinë e njerëzve ose të të afërmeve të

cilët jetojnë me zyrtarin e lartë. E citoi diskutimin e kaluar: *Për Agjencinë duhet të jetë publike tërë pasuria e një zyrtari të lartë, pavarësisht me kë jeton. Në faqe të internetit të publikohet ajo pasuri e cila fitohet prej momentit kur zyrtari i lartë e merr detyrën, deri një vit pas skadimit të mandatit, siç e parasheh ligji.* E them këtë duke e pasur parasysh çështjen e pronësisë ende të pazgjidhur në Kosovë.

Ibrahim Makolli - Tha se nuk është e vërtetë që si anëtarë të Komisionit jemi kundër transparencës, sepse me asnjë veprim dhe në asnjë diskutim tonin nuk e kemi thënë këtë. Nuk është transparencë vetëm nëse dikush e bën publike pasurinë. Ajo ka edhe forma të tjera, nëpërmjet të cilave opinioni ka qasje edhe informata. Në asnjë rast pasuria e zyrtarit të lartë nuk është e fshehur për mekanizmat dhe për institucionet që merren me mbikëqyrjen e pasurisë, siç janë Agjencia dhe gjykata që bëjnë kontrollin.

Bajram Kosumi - Ia tërhoqi vërejtjen kryetarit lidhur me udhëheqjen e mbledhjes, sepse po diskutohen çështje të cilat i kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe po debatohet me pjesëmarrës që nuk janë anëtarë të Komisionit.

Georgi Rupchev - Propozoi që në nenin 10.3 të Projektligjit të shtohet edhe një fjali: *Përfshihen sipas nenit 4, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare, nuk mund të aplikohen në mënyrë që të refuzohet qasja publike në regjistër.*

Kryetari, propozimin e parafolësit e qiti në votim, i cili i aprovua nga Komisioni, ndërsa neni 10.pika 9 mbeti si në Projektligj.

Bajram Kosumi - Abstenoi në votim për nenin 10.9 me arsyetimin se është diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe jemi pajtuar të mbetet si në Projektligj.

Armend Zemaj - Paraqiti arsyetimin për propozimamendamentin 11, sipas të cilit Agjencia ka të drejtë ta propozojë shqiptimin e gjobës për mosdeklarim të rregullt të pasurisë, ndërsa ekzekutimin e bën organizata buxhetore. Ne si nënkomision nuk kemi bërë ndonjë ndryshim të madh, përveç në lartësinë e gjobës së cekur. Mund edhe t'i heqim këto dispozita ndëshkimore, ngase neni 14.3 thotë: *Agjencia i publikon emrat e zyrtarëve të lartë publikë të cilët nuk e kanë dorëzuar formularin për gjendjen e pasurisë, ashtu siç parashihet në këtë ligj.* Konsideroj se nuk ka ndëshkim më të madh se publikimi në media se zyrtari nuk e ka deklaruar pasurinë.

Kryetari - Propozoi të formulohej neni 14.1: *Për çdo shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik bën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë prej 150 deri 1000 euro.* Në momentin kur Agjencia konstaton se zyrtari nuk e paguan gjobën, i drejtohet gjykatës kompetente. Ndërsa 14.1.2, mbetet si në Projektligj, neni 14, pika 1.3 hiqet, neni 14.1.4 mbetet si në Projektligj. Propozimamendamenti 12, neni 15, pika 1 mbetet si në Projektligj, ndërsa neni 15, pika 5 riformulohet: *Nëse zyrtari i lartë publik nuk e dorëzon formularin për gjendjen e pasurisë, Agjencia e njofton institucionin përgjegjës.*

Propozimamandamentet 13,14,15 dhe 16, nenet 16,17,18,19 hiqen.

Çështja e dhuratave mbetet të diskutohet në një takim të radhës.

Shqyrtimi i kërkesës se Institutit Gjyqësor të Kosovës

Lidhur me këtë pikë nuk pati debat. Mbetet të shqyrtohet në mbledhjet e radhës.

Të ndryshme

Nuk pati debat.

E hartoi:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni